

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.13.12.2021*

13.12.2021

Ora 14:10

RENDI I DITËS

Hedhja e shortit “Për caktimin e relatorit të kërkesës nr.1 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për vendosje sanksioni administrativ, vendimi nr.467, dt.11.11.2021 të KSHZ”.

PJESËMARRJA :

- **Stafi KQZ: Y. Merkaj, E. Mema**

Z. Y. Merkaj: Përshëndetje, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve nëpërmjet vendimit nr. 477, dt. 11.11.2021 ka shqyrtuar ankimin administrativ të shkeljes së dispozitave të Kodit Zgjedhor në lidhje me zhvillimin e fushatës elektorale në ambienten e Bibliotekës “Moikom Zeqo”. Përfundimisht ka vendosur konstatimin e shkeljes nga ana e administratorit të Njesisë Administrative nr.2 si dhe ka kërkuar t'i propozojë KAS-it, vendosjen e sanksionit administrativ. Bazuar në nenin 21 pika “dh” të Kodit Zgjedhor, ky vendim i përcillet Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve, të cilët kanë vendosur sot në orën 12:00, që të zhvillohet seanca e shortit për caktimin e relatorit për këtë ankim administrativ të mësipërm i cili është me numër 1. Procedura e përcaktimit të relatorit është e njëjtë si në procedurat e kaluara. Bazuar në nenin 14 të Rregullores së KAS-it, kemi përgatitur pesë shirita letre, në njërin prej të cilave është vendosur Kërkesa Ankimore nr. 1. Katër shiritat e tjerë janë të bardhë dhe pa shënime. Viojmë më tej, pasi palosen shiritat, vendosen në pesë gogla me ngjyrë, formë dhe peshë të njëjtë, e më pas në një enë transparente. Duke qenë se anëtarët e KAS-it nuk janë prezent, kanë autorizuar një përfaqësues nga administrata e KQZ-

**Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.13.12.2021*

së e cila pasi i trazon vazhdon me tërheqjen e goglave në emër dhe për llogari të anëtarëve të KAS-it, duke filluar nga rendi alfabetik rritës. Vazhdojmë procedurën: Tërhiqet gogla në emër dhe për llogari të zotit Elvin Lako - shiriti del i bardhë dhe pa shënime.

Tërhiqet gogla në emër dhe për llogari të zotit Elvis Çefa - në shirit është Kërkesa Ankimore nr.1.

Vazhdojmë me goglat e tjera:

Tërhiqet gogla në emër dhe për llogari të zotit Ilir Rusmali - shiriti del i bardhë dhe pa shënime.

Tërhiqet gogla në emër dhe për llogari të zotit Koli Bele - shiriti është i bardhë dhe pa shënime.

Tërhiqet gogla në emër dhe për llogari të zotit Ledio Braho - shiriti është i bardhë dhe pa shënime.

Atëherë, në përfundim të procedurës së shortit caktohet zoti Elvis Çefa, relator i Kërkesës Ankimore nr.1, faleminderit!

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

